

VENDIM
Nr. 205, datë 13.3.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, NJË KAT DHE TRUALLI, PJESE E SHTËPISË SË FAMILJES RAPO,
NDODHUR NË LAGJEN “PALORTO”, GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, një kat dhe truall, ndodhur në lagjen “Palorto”, Gjirokastrë.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Gjirokastrë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen, banesë dhe tokë truall, 27 (njëzet e shtatë) m², të vlerësuar me çmimin e banesës 49 000 (dyzet e nëntë mijë) lekë/m² dhe çmimin e truallit 6000 (gjashtë mijë) lekë/m², me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 1 477 000 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 477 000 (një milion e katërqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekësh, të përballohet nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
 6. Regjistrimi i ri i pasurisë, një kat dhe tokë truall, me sipërfaqe 27 (njëzet e shtatë) m², shpronësuar në favor të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare, Gjirokastrë, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
 7. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha